



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
KOMISIONI I ZGJEDHJEVE**

IV. Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike

(Kriteret e dhe procedurat)

Mbështetur: **1.** Ligjit nr. 9655 datë 11.12.2006 *Për Akademinë e Shkencave të Rrepublicës së Shqipërisë*, neni 11 *Mënyra e zgjedhjes së Kryesisë* (ndryshuar me Ligjin nr. 9853, datë 26.12.2007, neni 7); **2.** *Statutit organik të saj*, neni 17 dhe neni 18; **3.** *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*;

Me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Seksionit të Shkencave Teknike dhe Natyrore (më tej: SSHTN) më 28 maj 2019;

Përmes kësaj thirrjeje publike ftohen për konkurrim anëtarët e Asamblesë me titullin *akademik, akademik i përhershëm ose akademik i asociuar*;

I. Kërkesa për dokumentacion:

Sipas procedurës së parashikuar në Statut, kandidatët duhet të paraqesin pranë Akademisë së Shkencave:

- 1.** Kërkesë vetjake për aplikim drejtuar Asamblesë së Akademisë së Shkencave;
- 2.** Fotokopje të kartës së identitetit / pasaportës;
- 3.** Curriculum Vitae;
- 4.** Listë të studimeve të botuara (monografi, artikuj);
- 5.** Platformë për mënyrën e ushtrimit të funksioneve të tij për mbarëvajtjen e Akademisë së Shkencave gjatë mandatit të tij;
- 6.** Formular aplikimi për informim për zyrtarët para emërimit / zgjedhjes në poste të larta (sipas nenit 29, pika 1, germa gj, të Ligiit nr. 45/2015 *Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*);
- 7.** Formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit konfirmohet mosekzistenca e shkaqeve penguese për të kandiduar, për të mos u zgjedhur ose emëruar,

sipas Ligjit nr. 138/2015 *Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*. Formulari gjendet në webin e Akademisë së Shkencave, në linkun e mëposhtëm:

<http://akad.gov.al/ash/legjislacioni/formular-vetedeklarimi>

II. Kalendar i procesit zgjedhor:

1. Pranimi i dokumentacionit për konkurrim është nga data 10 prill 2019 deri më 10 maj 2019.
2. Procesi i verifikimit në rrugë institucionale të garancive ligjore sipas pikave 6 dhe 7, nga data 10 deri më 15 maj 2018;
3. Mbledhja e Asamblesë për votimin e kandidaturave do të zhvillohet më 24 maj 2019, ora 10.00, në sallën *Aleks Buda*.
4. Para votimit kandidatët do të paraqesin projektin e tyre për drejtimin e institucionit. Koha në dispozicion të çdo kandidati është 15 minuta. Anëtarët e Asamblesë kanë të drejtë të bëjnë pyetje rreth projekteve.

III. Procedura e konkurrimit dhe e votimit:

1. Kandidatë për funksionin e Kryetarit të SSHTN në Akademinë e Shkencave mund të jenë *anëtarët e rregullt, anëtarët e përhershëm ose anëtarët e asociuar* të Asamblesë;
2. Zgjedhja e Kryetarit të SSHTN bëhet me votim të fshehtë nga Asambleja, pa debat.
3. Shpallet i zgjedhur në funksionin e Kryetarit të SSHTN kandidati që fiton shumicën absolute (50 për qind +1) të votave të gjithë anëtarëve të Asamblesë.
4. Në rast se në votimin e parë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota.
5. Në rast se edhe në votimin e dytë asnjë nga kandidatët nuk fiton, votimi përsëritet dhe fitues shpallet kandidati me 50 për qind + 1 të anëtarëve Asamblesë të pranishëm në votim.
6. Mandati në detyrë është 4-vjeçar dhe fillon ditën e zgjedhjes nga Asambleja. Mandati i Kryetarit të SSHTN nuk përsëritet dy herë rresht.

IV. Detyrat e Kryetarit të SSHTN, sipas rregullores së brendshme të Akademisë së Shkencave, kreu III, *Funksionet drejtuese*, neni 17, janë:

Kryetari i SSHTN është drejtues i seksionit dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Akademisë së Shkencave. Detyrat e tij janë:

- Në bashkëpunim me akademikë të fushave të shkencave natyrore dhe teknike dhe me sektorë dhe departamente të institucioneve ku akademikët bëjnë pjesë, përcakton përparësitë e kërkimit shkencor të fushave të ndryshme;

- Organizon bashkërendimin e veprimtarisë shkencore për fushat e shkencave natyrore dhe teknike;
- Studion perspektivat e zhvillimit të shkencave natyrore e teknike dhe bën propozime konkrete për çelje sektorësh në përputhje me detyrat shkencore perspektive;
- Ndjek veprimtarinë shkencore botuese të akademikëve përkatës dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, si dhe planifikon botimet e tyre shkencore individuale apo në grupe të përbashkëta shkencore, për t'i paraqitur ato në këshillin e botimeve të Akademisë;
- Propozon dhe merr masa për organizimin e kongreseve shkencore kombëtare, ndërkombëtare apo seminareve, simpoziumeve, konferencave, si dhe për hartimin e rekomandimeve drejtuar institucioneve të ndryshme;
- Propozon në seksion, ngre dhe ndjek funksionimin e grupeve *ad hoc* apo të komisioneve me specialistë brenda dhe jashtë Akademisë, për probleme të rëndësishme në fushat përkatëse;
- Kontribuon në hartimin e programeve qeveritare për kërkim dhe zhvillim, si në programet kombëtare të kërkimit e zhvillimit, strategjitë e ndryshme, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit e institucione të tjera të vendit;
- Organizon dhe drejton botime në revistën shkencore të seksionit JNTS (*Journal of Natural and Technical Sciences*) dhe në revista të tjera me bashkautorësi institucionale që botohen në gjuhën shqipe ose në gjuhë të huaj;
- Paraqet në Kryesi dhe në Asamble analiza për gjendjen e kërkimeve në fusha të ndryshme, projekte për drejtimet themelore të studimeve në fushat përkatëse;
- Ndjek realizimin e detyrave të seksionit, që rrjedhin nga protokollat e bashkëpunimit dypalësh të Akademisë;
- Shqyrton dhe jep mendim për kandidatët që aplikojnë për akademikë të rregullt, të asociuar ose të përhershëm që paraqiten në Asamble;
- Propozon në Kryesi kandidaturat për titullin *anëtar nderi i Akademisë*. - Organizon dhe drejton veprimtarinë administrative të SSHTN;
- Organizon punën për hartimin e raportit mbi veprimtarinë vjetore të seksionit, brenda përfundimit të vitit;
- Si epror i drejtpërdrejtë bën vlerësimin e punës për nëpunësit civilë në varësi të tij;
- Kryen veprimtari kërkimore shkencore vetjake.